



## ANALIZË E POLITIKAVE

Nr. 2/15 – Korrik 2015

# KËRKESAT E BE-SË PËR KOSOVËN: LUFTA KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ

Ky projekt është përkrahur nga Komisioni Evropian, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.



Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim i takojnë KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamjet e Komisionit Evropian, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Përgatitur nga: Ariana Qosaj-Mustafa,

Violeta Haxholli, Njomza Sejdullahu

Hulumtimi është mbështetur nga: Vlora Gaxheri dhe Besart Zhuja

E drejta autoriale © 2015 KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem ruajtës apo të transmetohet në ndonjë formë apo me anë të ndonjë mjeti, qoftë elektronik, mekanik, fotokopjim, incizues apo të tjera, pa lejen paraprake të publikuesit. Luteni të kontaktoni [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) apo +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave  
Rr. Abdyl Frashëri, Nr.44  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Tel : +381 38 227 778  
[www.kipred.org](http://www.kipred.org)



Syri i Vizionit  
Rr. Isa Demaj, Nr. 14, 30000  
Pejë, Kosovë  
Tel. +381 (0) 39 423 240  
[www.syriivizionit.org](http://www.syriivizionit.org)

## **PËRMBAJTJA**

I. Përmbledhje Ekzekutive .....	1
II. Kushtet e përgjithshme të BE-së në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore .....	2
III. Përkufizimi i krimit të trafikimit me qenie njerëzore.....	4
IV. Përgjegjësia në implementimin e ligjit.....	8
a) Hetimi i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore.....	9
b) Ndjekja dhe dënimi i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore.....	13
V. Përpyqjet e tjera kundër trafikimit.....	15
a) Roli i Koordinatorit Nacional në luftimin e trafikimit.....	15
b) Ndihma në integrimin e viktimave të trafikimit .....	16
a) Përpyqjet e kundër trafikimit në luftimin e lypjes së detyruar tek fëmijët.....	17
VI. Përfundim dhe Rruga Përpara.....	20
Rekomandime:.....	20
VII. Shtojca:.....	22

## I. Përmbledhje Ekzekutive

Luftimi i trafikimit me qenie njerëzore vazhdon të jetë një ndër kushtet e Bashkimit Evropian (BE) për Kosovën. Në këtë drejtim janë dhënë disa vërejtje në Raportet e Progresit për Kosovën, si dhe në raportet e progresit për përmbushjen e kushteve në lidhje me Udhëzuesin për Liberalizimin e Vizave. Me përjashtim të BE-së, edhe Raporti në lidhje me Trafikimin me Qenie Njerëzore i Departamentit Amerikan të Shtetit ka vënë në pah se, Kosova vazhdon të jetë burim dhe vend transiti i trafikimit me qenie njerëzore.<sup>1</sup> Për më tepër, raporti thekson se Qeveria e Kosovës (QeK) nuk vepron plotësisht në bazë të standardeve minimale të përcaktuara për eliminimin e trafikimit, edhe pse është duke bërë përpjekje të dukshme për të vepruar në atë drejtim.

Që nga viti 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë e saj, ka pasur kritika të ngjashme drejtuar ndjekjes joefektive dhe dënimit joadekuat të krimit të trafikimit. Mekanizmat plotësues ligjor dhe institucional janë krijuar në Kosovë duke filluar nga njësitë e specializuara në hetimin e trafikimit brenda Policisë së Kosovës, institucionet për mbrojtjen e viktimave në mënyrë që të adresohet çështja e përfaqësimit të viktimave të trafikimit pranë gjykatave, si dhe janë krijuar shërbimet e specializuara të OJQ-ve me qëllim të ofrimit të ndihmës ndaj viktimave të trafikimit. Megjithatë, qasja ka mbetur e përqendruar më tepër tek mbrojtja dhe parandalimi i trafikimit se sa tek kryerja e hetimeve serioze penale për të kapur grupet e organizuara të trafikimit dhe dënimi i duhur i autorëve të krimit të trafikimit.

Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore përcaktohet me anë të Kushtetutës së Kosovës, Kodit Penal si dhe Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit. Për më tepër, Kosova konsiderohet se posedon kornizë të mjaftueshme ligjore për të luftuar trafikimin me njerëz.<sup>2</sup> Konsiderohet se korniza ligjore dhe politike e vendit për të luftuar trafikimin me njerëz është shembull për shtetin rajonal të Shqipërisë, në përpjekjet e tij për të ndërtuar një model të njëjtë bazuar në veprimet e Kosovës.<sup>3</sup>

Pas vonesave të mëdha në përmbushjen e kushteve të BE-së, për shkak të bllokadës institucionale prej gjashtë muajve pas zgjedhjeve nacionale të muajit qershor 2014 dhe krijimit të Qeverisë së re të Kosovës, QeK vetëm së fundmi ka aprovuar Strategjinë e re dhe Planin e Veprimit në lidhje me Trafikimin me Qenie Njerëzore. Strategjia e re dhe Plani i Veprimit janë përpiluar dhe adoptuar edhe pse strategjia e mëparshme dhe plani i veprimit (2011-2014) nuk janë vlerësuar zyrtarisht në nivelin e vet të implementimit. Kosova gjithashtu u ka mohuar viktimave të trafikimit të drejtat e tyre për kompensim për krimin e trafikimit dhe BE-ja i ka kërkuar Kosovës që të adoptojë një ligj mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit, në mënyrë specifike duke u fokusuar në kompensimin e viktimave të trafikimit. Ligji është përpiluar së fundmi dhe si i tillë është adoptuar nga Kuvendi i Kosovës në muajin Maj të vitit 2015.<sup>4</sup>

Sfidat mbesin në hetimin, ndjekjen dhe qasjen e gjykatave ndaj lëndëve që lidhen me trafikimin me qenie njerëzore. Argumentimi me dëshmi të mjaftueshme dhe cilësore i lëndëve që lidhen me trafikimin me qenie njerëzore është thelbësor në mënyrë që të dënohen personat e përfshirë në

---

<sup>1</sup> Zyra për Monitorim dhe Luftim të Trafikimit me Njerëz, [2014 Raporti mbi trafikimin me njerëz](http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/countries/2014/226755.htm), Tier 2, i disponueshëm në: <http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/countries/2014/226755.htm>

<sup>2</sup> Syri i Vizionit (SiV) intervistë me gjyqtarin e Gjykatës Themelore të Gjakovës, 23 prill 2015.

<sup>3</sup> Intervista të KIPRED, mars-prill 2015, Prishtinë

<sup>4</sup> Portali elektronik i Kuvendit të Kosovës: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-036%20a.pdf>.

aktivitete kriminale që lidhen me trafikimin me qenie njerëzore.<sup>5</sup> Përdorimi i masave të intelegjencës pro-aktive për të shkatërruar grupet e mëdha kriminale mbetet akoma një sfidë për Kosovën, duke përfshirë këtu edhe hetimet për krimet e shpërlarjes së parave, si dhe trafikimin e drogës dhe të armëve. Për më tepër, “korrupsioni brenda qeverisë krijon një ambient të përshtatshëm për lejimin e disa krimeve të trafikimit.”<sup>6</sup> Konsiderohet se gjykatat shqiptojnë dënime të lehta dhe minimale ndaj autorëve të krimit edhe përkundër parashikimeve të ligjit kundër trafikimit me qenie njerëzore.

Shumica e viktimave në Kosovë vazhdojnë të jenë gra dhe vajza, kryesisht të trafikuar për qëllimet e shfrytëzimit seksual.<sup>7</sup> Gjithashtu është raportuar se në masë të madhe edhe burrat janë trafikuar, ndërsa lokalet e trafikimit janë transferuar nga motelet në shtëpi private, sallonet e masazhit dhe klubet e natës.<sup>8</sup> Integrimi i viktimave të trafikimit vazhdon të jetë gjithashtu një ndër sfidat më të mëdha. Strehimoret që u ofrojnë shërbime viktimave të trafikimit konfirmojnë se integrimi mbetet një sfidë ndër vite në Kosovë pasi që viktimat shpesh kthehen tek rrjetet e trafikimit, si rezultat i kapaciteteve të dobëta të integritit në Kosovë.

Bashkëpunimi dhe koordinimi me autoritetet kompetente për luftimin e trafikimit me njerëz duhet të përmirësohet edhe më tej, në veçanti, në aspektet e parandalimit, mbrojtjes dhe dënimit adekuat të autorëve të krimit të trafikimit me njerëz. Për më tepër, qeveria duhet të sigurojë asistencën e duhur për mbrojtjen dhe integrimin e viktimave të trafikimit, duke përfshirë edhe krijimin dhe përmbushjen efektive të kompensimit të viktimave të trafikimit. Mungesa e kompensimit të viktimave të trafikimit mbetet një shqetësim serioz, duke u mohuar kështu viktimave të trafikimit mundësinë për t’u fuqizuar dhe për të shfrytëzuar mundësinë e një integriti të qëndrueshëm. Rrjedhimisht, krimi i trafikimit mbetet një prioritet dhe një sfidë që të përmbushet nga ana e Kosovës, në mënyrë që Kosova të jetë në gjendje që të shkojë përpara drejt proceseve të saja të integritit në BE.

## **II. Kërkesat e përgjithshme të BE-së në luftimin e trafikimit me njerëz**

Lufta efektive kundër trafikimit me njerëz vazhdon të jetë një ndër kërkesat e Bashkimit Evropian (BE) për Kosovën. Në këtë drejtim janë dhënë disa vërejtje në Raportet e Progresit për Kosovën, si dhe në kërkesat e BE-së për institucionet e Kosovës në lidhje me kriteret e parapara me anë të Udhëzuesit për Liberalizimin e Vizave. Në Raportin e Progresit për Kosovën të vitit 2014 të Komisionit Evropian, është vënë në pah se, Kosova vazhdon të jetë një vend i origjinës, transitit dhe përcaktimit të trafikimit me qëllim të shfrytëzimit dhe punësimit seksual,<sup>9</sup> duke kërkuar që institucionet e Kosovës të reagojnë në mënyrë efektive në lidhje me këtë çështje.

Raporti ka rekomanduar që Kosova të rrisë përpjekjet e saja në përmirësimin e masave parandaluese në trafikim dhe të vlerësojë zbatimin e strategjisë aktuale dhe planin e veprimit kundër trafikimit me

<sup>5</sup> Ibid.

<sup>6</sup> Ka pasur disa zyrtarë policorë, zyrtarë ministrorë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe zyrtarë të tjerë qeveritarë që janë ngarkuar apo dënuar me krimet e trafikimit, shiko faqen 210 të Raportit të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve në lidhje me trafikimin me njerëz, 2015, Kapitulli në lidhje me Kosovën.

<sup>7</sup> Intervistë e KIPRED, maj 2015, përfaqësuesi i strehimores.

<sup>8</sup> Shiko Raportin e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve, “Trafikimi me Njerëz”, 2015, Kapitulli në lidhje me Kosovën, i cili mund të gjendet tek: <http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/countries/2015/243470.htm>

<sup>9</sup> Komisioni Evropian, 2014, Raporti i Progresit për Kosovën, faqe 51. Gjendet tek:

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf)

njerëz (2011-12) para se të adoptohet strategjia e re.<sup>10</sup> Raporti për më tepër thekson se Kosova duhet të zbatojë Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, ndërsa identifikimi i viktimave duhet të përmirësohet akoma më tepër.

Si një shenjë pozitive, raporti i progresit vëren zbulimin e disa grupeve të trafikimit nga ana e Policisë së Kosovës në vitin 2013. Megjithatë, shqetësimet mbesin në numrin e ulët të dënimeve dhe gjyqimeve të nxjerra në lëndët e trafikimit me njerëz.<sup>11</sup> Për më tepër, KE thekson nevojën për të përmirësuar kurset e trajnimit për gjyqtarët dhe prokurorët që trajtojnë lëndët e trafikimit. Gjithashtu, trajnimet në procedurat ekzistuese standarde dhe vepruese duhet të ofrohen për pjesëtarët e tjerë siç janë policia kufitare apo inspektorët e punës.<sup>12</sup> Në një aspekt pozitiv, raporti përmend fillimin e një sërë aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes publike me moton “Hapi Sytë e Tu” si dhe aktivitete të tjera me qëllim informimi, të organizuara dhe drejtuara nga ana e koordinatorit kundër trafikimit.

Në kuadër të çështjes së trafikimit të qenieve njerëzore, raporti i progresit vëren edhe shkallën e lartë të trafikimit të fëmijëve dhe shfrytëzimit të fëmijëve për qëllime të lypsarisë. Sipas këtij raporti, mungesa e ndërhyrjes së Policisë së Kosovës në rastet e lypsarisë së fëmijëve mbetet një shqetësim.<sup>13</sup>

KE-ja ka nxitur autoritetet e Kosovës që të përmirësojnë qasjen në drejtësi për viktimat e trafikimit.<sup>14</sup> Në lidhje me këtë, raporti përmend si një të metë mbylljen e tetë zyrave për ofrim të ndihmës juridike, të financuara nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), prej trembëdhjetë zyrave të tilla të drejtuara nga Komisioni Kosovar për Ndihmë Juridike.

Të gjetura të ngjashme të Raportit të Progresit të KE-së të vitit 2014 janë reflektuar edhe në raportin e dytë monitorues të Udhëzuesit për Liberalizimin e Vizave, në lidhje me progresin e Kosovës në përmbushjen e kushteve të BE-së.<sup>15</sup> Për më tepër, raporti thekson se numri i lëndëve të zbuluara dhe të hetuara të trafikimit me qenie njerëzore apo të trafikimit me substanca narkotike mbetet i ulët.<sup>16</sup> Raporti rendit disa rekomandime për autoritetet e Kosovës në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore në një mënyrë ndër-kufitare, duke themeluar një histori të vendimeve të formës së prerë të gjykatave në rastet që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore, duke përfshirë edhe ekzekutimin e rasteve penale dhe aseteve kriminale, duke ofruar rikuperim dhe duke siguruar mbështetje dhe ndihmë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.<sup>17</sup>

Kushtet e BE-së për Kosovën kanë qenë një taktikë e dobishme për të përshpejtuar reagimin e institucione kosovare në ndërmarrjen e masave të nevojshme për të adresuar kushtet në luftimin efikas të trafikimit me njerëz. Megjithatë, Kosova akoma ka nevojë që të zbatojë legjisllacionin e saj kundër trafikimit me njerëz, ndërsa në anën tjetër ka nevojë të rris nivelin e hetimeve, ndjekjen

---

<sup>10</sup> Ibid.

<sup>11</sup> Ibid, faqe 16.

<sup>12</sup> Ibid, faqe 51.

<sup>13</sup> Ibid.

<sup>14</sup> Ibid, faqe 14.

<sup>15</sup> Komisioni Evropian, Raporti i dytë i progresit i KE-së në lidhje me Kosovën për përmbushjen e kushteve të Udhëzuesit për Liberalizimin e Vizave, i cili gjendet tek: [http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/second\\_commission\\_assessment\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/second_commission_assessment_en.pdf)

<sup>16</sup> Ibid, faqe 3 citimi FRONTEX – Analiza Vjetore e Rrezikut të Ballkanit Perëndimor 2014.

<sup>17</sup> Ibid, faqe 4 dhe faqe 7.

penale dhe gjykimin e autorëve të krimit, gjëra që vazhdojnë të sfidojnë luftën efektive kundër trafikimit.

### III. Përkufizimi i krimit të trafikimit me njerëz

Kosova ka krijuar një sërë ligjesh dhe politikash, si reagim ndaj krimit të trafikimit me qenie njerëzore. Në Kushtetutën e saj Kosova në mënyrë vendimtare e ndalon trafikimin me njerëz, punën e detyruar dhe skllavërinë.<sup>18</sup> Sipas Kushtetutës, dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.<sup>19</sup>

Në linjë me Kodin Penal të Kosovës, shprehja “trafikim me njerëz” nënkupton rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim të personave me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.<sup>20</sup> Kryesisht grupet kriminale të trafikimit në Kosovë kanë shënjuar dhe viktimizuar gratë dhe vajzat për qëllim të shfrytëzimit seksual. Në vitet e fundit trafikimi me qëllim të punës së detyruar, përfshirë këtu lypësinë tek fëmijët, mbetet në shkallë të lartë.<sup>21</sup> Në rast të trafikimit me njerëz, pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh<sup>22</sup> nëse mjetet e shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit janë përdorur kundër viktimës së tillë. Sa i përket viktimave fëmijë (nën moshën 18 vjeçe) pëlqimi i viktimës është relevant edhe nëse janë përdorur mjetet e përmendura me sipër, dhe rrjedhimisht rastet e tilla konsiderohen të jenë vepra penale të trafikimit me njerëz.<sup>23</sup>

Gjithashtu Ligji i Kosovës parasheh dënime të ndryshme për sa i përket formës se si është kryer trafikimi me njerëz. Dënimet klasifikohen prej 5 deri në 12 vite burgim, në rast të përfshirjes në veprën penale, ndërsa kur vepra penale kryhet në një perimetër prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët ose kur vepra kryhet ndaj personit nën moshën tetëmbëdhjetë vjet, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.<sup>24</sup> Megjithatë paragrafi 2 i nenit 171 i Kodit Penal nuk është në përputhje me paragrafin e pare, pasi që paragrafi i parë përcakton një dënim minimal prej 5 vjetësh dhe jo 3 vjetësh, siç është përcaktuar gabimisht në paragrafin 1. Kjo mos-përputhje mund të shkaktojë huti tek gjyqtarët gjatë zbatimit të ligjit, pasi që janë të detyruar që të zbatojnë ligjin *ad literam*, dhe rrjedhimisht të shqiptojnë dënimet në bazë të minimumit të lejuar për dënime të tilla.

Për më tepër, Kodi Penal parasheh dënime të rënda nëse trafikimi ndodh nga një grup i organizuar kriminal<sup>25</sup> apo nga një person zyrtar, i cili abuzon me pozitën e tij/saj zyrtare.<sup>26</sup> Veç kësaj, nëse vepra

---

<sup>18</sup> Shih Nenin 28 të Kushtetutës së Kosovës

<http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>

<sup>19</sup> Ibid, Neni 23.

<sup>20</sup> Neni 171, paragrafi 6.1 i Kodit Penal të Kosovës: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

<sup>21</sup> Komisioni Evropian, 2014, Raporti i Progresit për Kosovën, faqe 52.

<sup>22</sup> Ibid, Neni 171, paragrafi 6.3.

<sup>23</sup> Neni 5.3 i Ligjit mbi Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.

<sup>24</sup> Ibid, Neni 171, paragrafi 1 dhe 2.

<sup>25</sup> Ibid, Neni 171, paragrafi 3.

penale rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, autori i krimit dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.<sup>27</sup> Kodi Penal parasheh gjithashtu se kushdo që fsheh dokumentet personale të identifikimit apo pasaportën e personit për të cilin e din se është viktimë e veprës penale, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.<sup>28</sup> Një gjobë më e lartë do të shqiptohet nëse vepra penale kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorimin të pozitës zyrtare.<sup>29</sup>

Pos Kodit Penal, institucionet e Kosovës në shtator të vitit 2013 adaptuan edhe Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit. Ligji u përpilua dhe adoptua si reagim i institucioneve të Kosovës ndaj kërkesave të BE-së për të themeluar një ligj gjithëpërfshirës kundër trafikimit, bazuar kryesisht në Udhëzimin e BE-së 2011/36 mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.<sup>30</sup> Ligji ofron një sërë dispozitash ligjore gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe parandalimin e trafikimit me njerëz në të gjitha format e saja nëpërmjet bashkëpunimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit duke u ofruar atyre ndihmë juridike, mjekësore, mbështetje fizike dhe sociale, si dhe kompensim. Ky ligj i përcakton parimet,<sup>31</sup> ku duhet të bazohet lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore, elementet<sup>32</sup> e veprës penale të trafikimit me njerëz, dhe përkufizimin e autoriteteve për mbrojtjen dhe parandalimin e trafikimit me njerëz. Ligji gjithashtu parasheh qartë edhe institucionet përgjegjëse, në mënyrë specifike Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurial të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, etj.<sup>33</sup>

---

<sup>26</sup> Ibid, Neni 171, paragrafi 4.1 dhe 4.2.

<sup>27</sup> Ibid, Neni 171, Paragrafi 5.

<sup>28</sup> Ibid, Neni 172, Paragrafi 1.

<sup>29</sup> Ibid, Neni 172, Paragrafi 2: Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorimin e pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.

<sup>30</sup> Gjetendet pranë: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2011:101:0001:0011:EN:PDF>.

<sup>31</sup> Neni 4 i Ligjit Nr. 04/L-218 Ligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, i cili gjendet në:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20preventing%20and%20combating%20trafficking%20in%20human%20beings.pdf>.

Luftimi i trafikimit me njerëz bëhet në bazë të këtyre parimeve: respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, në veçanti të viktimave të ndjeshme; njohja e trafikimit me njerëz si vepër penale që prek të drejtat themelore të njeriut, dinjtetin, lirinë dhe integritetin e njerëzve... zbatimi i dispozitave të këtij ligji, ... pa diskriminim mbi çfarëdo baze: gjinisë, racës, gjuhës, fesë, mendimit politik apo ndryshe, origjinës sociale apo nacionale, shtetësisë, asociimit, përkatësisë me një pakicë etnike etj.

<sup>32</sup> Shih Neni 5 i Ligjit Nr. 04/L-218, elementet e trafikimit me njerëz përbëhen nga: 1. rekrutimi, 2. transportimi, 3. transferimi, 4. strehimi apo pranimi i personave, me anë të kanosjes dhe përdorimit të forcës apo formave tjera të shtrëngimit, 5. rrëmbimit, 6. mashtrimit, 7. lajthimit, 8. keqpërdorimit të pushtetit apo keqpërdorimit të pozitës së ndjeshme dhe 9. dhënia apo marrja e pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, për qëllim të shfrytëzimit.

<sup>33</sup> Ibid, Neni 6, Paragrafi 1.7.-1.18 Autoritetet kompetente për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz, dhe ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuar janë: Ministria e Punëve të Brendshme; Policia e Kosovës; Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Këshilli Prokurorial i Kosovës; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; 1 Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Financave; Agjencia për Barazi Gjinore Prokurori i Shtetit; Gjykatat; Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Komunitat, dhe çdo ofrues i shërbimeve në kuadër të këtyre institucioneve, i cili në bazë të këtij ligji apo ndonjë ligj tjetër përkatës është i autorizuar



Me anë të këtij ligji është themeluar gjithashtu edhe Autoriteti Kombëtar kundër trafikimit me njerëz, i cili përbëhet nga autoritetet e përmendura më sipër dhe institucionet e tjera shtetërore relevante nga fusha të ndryshme, dhe drejtohet nga Koordinatorin Nacional Kundër Trafikimit me Njerëz (në tekstin e mëtejshëm: Koordinatorin Nacional Kundër Trafikimit) i emëruar nga qeveria.<sup>34</sup> Prej krijimit të qeverisë së re në dhjetor të vitit 2014, qeveria nuk ka arritur që të emërojë Koordinatorin Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz me një vendim të qeverisë, që në të kaluarën është bërë në mungesë nga pozita e zëvendës Ministrit të Punëve të Brendshme (MPB). Gjithashtu në vitin 2013 qeveria kishte adaptuar Udhëzimin Administrativ (UA) me qëllim të caktimit të procedurave për përbërje formale, caktimin e kompetencave, përgjegjësisve dhe funksionimit të autoritetit kombëtar kundër trafikimit.<sup>35</sup> Deri në periudhën raportuese, Ministria e Punëve të Brendshme pretendon se në mungesë, Ministri konsiderohet se luan rolin e Koordinatorit Nacional Kundër Trafikimit me Njerëz.<sup>36</sup>

Ndryshe, Ligji gjithashtu rregullon procedurat e hetimit dhe ndjekjes penale<sup>37</sup> në lidhje me shkeljet penale të trafikimit me njerëz. Identifikimi zyrtar i viktimave kryhet nga njësitë përkatëse të Policisë, Prokuroria, Mbrojtësit e Viktimave dhe Qendrave për Punë Sociale, kurdo që kanë dyshime të bazuara për të besuar se persona të caktuar janë viktimë e trafikimit, të theksuara gjithashtu edhe në Procedurat Standarde të Veprimit (SPV-të).<sup>38</sup> Të ashtuquajturat SPV-të për mbrojtjen nga dhuna në familje<sup>39</sup> janë adaptuar me qëllim të mbrojtjes dhe ofrimit të asistencës ndaj viktimave të dhunës, përfshirë edhe viktimat e trafikimit. Qeveria gjithashtu ka adaptuar UA për identifikim të hershëm të viktimave të trafikimit me njerëz nga shërbimet konsullore, policia kufitare dhe inspektorati i punës.<sup>40</sup>

Ligji gjithashtu specifikon format e ofrimit të ndihmave, të drejtat dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, përfshirë të drejtën e viktimës për t'u trajtuar si palë në procedurë.<sup>41</sup> Kjo e ka fuqizuar pozitën e viktimës në procedurat penale dhe si e tillë përbënë novacion në Kodin e ri të Procedurës Penale të Kosovës, e që reflektohet gjithashtu edhe nga Ligji i ri kundër trafikimit. Ligji gjithashtu parasheh aftësimin profesional i viktimave të trafikimit<sup>42</sup> pa pagesë në mënyrë të lehtësimit të reintegrimit të viktimave në shoqëri.

Një çështje tjetër që mbulon ligji është në veçanti trafikimi me fëmijë, i cili ofron të drejtat e garantuara me anë të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës.<sup>43</sup> Për më tepër,

---

që të merret me parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe sigurimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuar

<sup>34</sup> Neni 8.1, Emërtimi dhe Kompetencat e Koordinatorit Nacional kundër Trafikimit me Njerëz

<sup>35</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2013 për përbërjen formale, kompetencat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të autoritetit kombëtar kundër trafikimit me njerëz, gjendet te <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10313>

<sup>36</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtarë të MPB-së, maj 2015. Konfirmuar në tryezën e rumbullakët të KIPRED dhe SiV, me temën “Kushtet e BE-së për Kosovën: Lufta kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore” 29 maj 2015, Prishtinë.

<sup>37</sup> Ligji për Parandalimin e Luftimit e Trafikimit me Qenie Njerëzore, Kapitulli III.

<sup>38</sup> Ibid, Neni 12, identifikimi zyrtar i viktimave të trafikimit.

<sup>39</sup> Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë, Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Agjencinë për Barazi Gjinore, Prishtina 2013, në [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Procedurat\\_Standarde\\_te\\_Veprimit\\_per\\_Mbrojtje nga Dhuna ne Familje.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Procedurat_Standarde_te_Veprimit_per_Mbrojtje nga Dhuna ne Familje.pdf)

<sup>40</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2014 për identifikimin e hershëm të viktimave të trafikimit me njerëz nga shërbimet konsullore, policia kufitare dhe inspektorati i punës, at <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10279>

<sup>41</sup> Ligji për Parandalimin e Luftimit e Trafikimit me Qenie Njerëzore, Neni 20, paragrafi 2.2.

<sup>42</sup> Ibid, Neni 24, Aftësimi profesional i viktimave të trafikimit.

<sup>43</sup> Ibid, shih Neni 35, Parimet e posaçme të luftimit të trafikimit me fëmijë.

ai parasheh kthimin në atdhe e një fëmijë viktimë e trafikimit, ofrimin e asistencës dhe mbrojtjen e fëmijëve, duke ofruar kujdes afat-gjatë dhe mbrojtje deri në rikuperimin e plotë të tyre.<sup>44</sup> Megjithatë, Raporti i Progresit i BE-së e vë në pah si një shqetësim shkallën e lartë të trafikimit me fëmijë dhe shfrytëzimin e fëmijëve për qëllime të lypsarisë në Kosovë.<sup>45</sup>

Për sa i përket kompensimit të viktimave të trafikimit, Kosova për vite e ka mohuar çdo formë të kompensimit ndaj viktimave për krimet e përjetuara. Legjislacioni ka ekzistuar, megjithatë zbatueshmëria e tij ka ngecur për vite të tëra. Për më tepër në vitin 2013 Kodi Penal i Kosovës parashikoi edhe krijimin e Fondi për Kompensim të Viktimave - fond në të cilin depozitohen mjetet nga konfiskimi i dorëzarisë dhe pasurive tjera të autorizuarra më ligj.<sup>46</sup> Pasi që asnjë prej tyre nuk ishte funksionalizuar, Ligji kundër trafikimit gjithashtu parashikoi përshkrimin e këtyre formave të kompensimit: kompensim nga ana autorëve të krimit, sipas urdhrit të gjykatës; dëmet të cilat urdhërohen të paguhen gjatë procedurave civile, përfshirë edhe aktin ligjor të kompensimit të viktimave. Përderisa kompensimi është i rregulluar me Kodin e Procedurës Penale dhe e drejta për të iniciuar një akt civil është e rregulluar me Ligjin mbi Procedurën Kontestimore, kompensimi shtetëror ka mbetur jo efektiv për vite të tëra të implementimit. Ministria e Drejtësisë ka gjetur një zgjidhje për këtë çështje duke projektuar edhe një ligj, me fjalë të tjera Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i cili është adaptuar së voni nga ana e Kuvendit të Kosovës.<sup>47</sup> Se në çfarë shkalle do të zbatohet ky ligj, mbetet që të vlerësohet në të ardhmen.

Projektligji i Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit rregullon të drejtën e kompensimit financiar të të gjitha viktimave të krimit, d.m.th. të viktimave të veprave të dhunshme penale dhe të vartësve të tyre, autoritetet vendimmarrëse si dhe procedurat për realizimin e të drejtës për kompensim në situatat vendore dhe ndërkuftare.<sup>48</sup> Sipas këtij ligji, viktimë e krimit nënkuptohet viktimë siç definohet me Kodin e Procedurës Penale.<sup>49</sup> Ligji në nenin 7 gjithashtu parasheh kushtet formale dhe materiale për të drejtën në kompensim, që duhet të plotësohen nga ana e parashtruesve të kërkesës. Gjithashtu ky ligj themelon edhe Komisioni për kompensim të viktimave të krimit, i cili do të jetë edhe organi vendimmarrës në lidhje me këtë. Gjithashtu parashihet që pjesë e këtij komisioni të jenë edhe dy përfaqësues nga shoqëria civile.<sup>50</sup>

Në mënyrë që të financohet Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ligji i referohet buxhetit të Republikës së Kosovës, d.m.th. Ministrisë së Drejtësisë dhe buxhetit të tyre vjetor,<sup>51</sup> por ai mund edhe të financohet nga kontributet vullnetare dhe donacionet private në pajtim me Rregullat e Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar.<sup>52</sup> Niveli i ndarjeve buxhetore për programin e kompensimit të viktimave të krimit do të bëhet përmes proceseve të rregullta buxhetore, duke marrë parasysh të hyrat e pritura nga të hyrat nga shitja e pasurisë së paligjshme të konfiskuar dhe kërkesave për

<sup>44</sup> Ibid, Neni 38, Dhënia e ndihmës dhe mbrojtja e fëmijëve që janë viktimë e trafikimit me njerëz, Paragrafi 12.

<sup>45</sup> Faqe 51 Raporti i Progresit për Kosovë, 2014, Komisioni Evropian, i disponueshëm tek, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf)

<sup>46</sup> Neni 19, paragrafi 1.26, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

<sup>47</sup> Shih faqen elektronike të Kuvendit të Kosovës: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-036%20a.pdf>.

<sup>48</sup> Projektligji i Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Neni 2, i disponueshëm tek [http://www.md-ks.net/repository/docs/Projektligji\\_per\\_kompensimin\\_e\\_viktimave\\_19\\_03\\_2015\\_\(2\).pdf](http://www.md-ks.net/repository/docs/Projektligji_per_kompensimin_e_viktimave_19_03_2015_(2).pdf)

<sup>49</sup> Ibid, Neni 3.1. Për më tepër shih nenin 19, paragrafi 1.7 Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

<sup>50</sup> Ibid, Neni 23, paragrafi 5.

<sup>51</sup> Ibid, Neni 40, Financimi për Kompensimin e Viktimave të Krimit, paragrafi 1.

<sup>52</sup> Ibid, Neni 40, paragrafi 2.

financim nga Buxheti i Kosovës.<sup>53</sup> Pavarësisht nga dispozitat e përcaktuara me ligj, implementimi i këtij ligji do jetë një sfidë.<sup>54</sup> Asetet e grumbulluara që konsiderohen si burime mund të mos jenë të mjaftueshme, duke pasur parasysh faktin se në vitin 2014 shuma e aseteve të konfiskuara është përlllogaritur të jetë prej 500,000 deri në 1,000,000 Euro, dhe për çerekun e parë të vitit 2015 janë konfiskuar asete në vlerë prej vetëm 64.487 Euro.<sup>55</sup> Rrjedhimisht, Ministria e Drejtësisë ka nevojë që të jetë novatore në qasjet e saja dhe të hulumtojë modalitetet për financime shtesë në mënyrë që të kompensojë viktimat e krimit.

Edhe pse Kosova ka një kornizë solide ligjore në vend për të luftuar trafikimin në përputhje me kërkesat ndërkombëtare, përkatësisht Udhëzimin e BE-së 2011/36, zbatimi i përgjithshëm i ligjit përkatës kundër trafikimit, vazhdon të jetë një sfidë. Në veçanti, mungesa e bashkëpunimit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme për të emëruar me një vendim qeverie Koordinatorin Nacional Kundër Trafikimit mbetet edhe një nga fushat e ligjit që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme nga ana e Qeverisë së Kosovës në mënyrë që të përmbushen kërkesat e BE-së për liberalizimin e vizave. Në fund, edhe zbatimi i Ligjit për Kompensim të Viktimave të Krimit, duke u fokusuar në financimin e Programit për Kompensim të Viktimave të Krimit, duhet të konsiderohet nga ana e qeverisë si prioritet i menjëhershme i qeverisë.

#### IV. Reagimi në zbatimin e ligjit

Siç është vënë në pah më lart një ndër vërejtjet pozitive të BE-së ka qenë zbulimi i disa grupeve të trafikimit nga ana e Policisë së Kosovës (PK). Raporti i Progresit i vitit 2014 i referohet rezultateve të PK-së në vitin 2013 kur ishin zbuluar shtatë grupe kriminale të përfshira në trafikimin me njerëz. Megjithatë, janë cilësuar si të dobëta në veçanti iniciativat e policisë në fuqizimin e kapaciteteve policore të intelegjencës.<sup>56</sup> Në mënyrë që të hetohen grupet e organizuara kriminale shpeshherë kapacitetet duhet të ndërtohen nëpërmjet indikacioneve strategjike të situatës së krimit të organizuar në Kosovë e kombinuar me modelin e intelegjencës funksionale dhe efektive. Ka pasur një përmirësim në grumbullimin, analizimin dhe zbulimin e informacionit brenda Shërbimit Informativ të Policisë së Kosovës.<sup>57</sup> Megjithatë numri i grupeve kriminale që janë shpërbërë nga Policia e Kosovës ende mbetet i ulët bazuar në operacionet e kryera në vitin 2013. Raporti TIP i SHBA-ve kritikoi gjithashtu Policinë e Kosovës se identifikimi i viktimave të trafikimit ka qenë më i ulët në vitet e fundit.<sup>58</sup> Gjithashtu dëshmohet nga ana e Raportit të Progresit të BE-së se identifikimi i viktimave të trafikimit ka nevojë të përmirësohet më tutje.<sup>59</sup> Për më tepër, mbetet një shqetësim numri i vogël i aktakuzave dhe gjyqimeve në lëndët e trafikimit.<sup>60</sup> Trajnimet e përbashkëta për të rritur kapacitetin e përgjegjësisë së zbatimit të ligjit, në veçanti nga Policia e Kosovës, mbetet një shqetësim i vazhdueshëm, për shkak të nevojës së identifikimit për të përmirësuar kurset e trajnimit

<sup>53</sup> Ibid, neni 140, paragrafi 5.

<sup>54</sup> Intervistë e KIPRED me Zyrтарin e Lartë të Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>55</sup> Komunikim elektronik i KIPRED me Koordinatorin Nacional për luftimin e krimeve ekonomike, 23 prill 2015.

<sup>56</sup> Faqe 51, Raporti i Progresit për Kosovë, 2014, Komisioni Evropian.

<sup>57</sup> Intervistë e KIPRED me këshilltarin e EULEX-it për PK.

<sup>58</sup> Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz, [2014 Trafficking in Persons Report](http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/countries/2014/226755.htm), Tier 2, i disponueshëm tek: <http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/countries/2014/226755.htm>. See also [2015 Trafficking in Persons Report](http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/countries/2014/226755.htm).

<sup>59</sup> Faqe 16 Raporti i Progresit për Kosovë, 2014, Komisioni Evropian.

<sup>60</sup> Faqe 16 Raporti i Progresit për Kosovë, 2014, Komisioni Evropian.

për gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët punojnë në lëndët e trafikimit, duke përfshirë këtu edhe policinë kufitare dhe inspektorët e punës.<sup>61</sup> Analiza e ofruar më poshtë paraqet një përmbledhje të të gjeturave të KIPRED-it gjatë monitorimit të përgjegjësive së zbatimit të ligjit në kohën gjatë periudhës mars 2015 deri në korrik 2015.

### **a) Hetimi i rasteve të trafikimit me njerëz**

Edhe pse Policia e Kosovës është lavdëruar për përpjekjet e saja në hetimin e rasteve të trafikimit, ndryshimet strukturore të menaxhmentit që kanë ndodhur në Policinë e Kosovës para dhe pas krijimit të qeverisë së re, te drejtuar nga PDK gjatë vitit 2010, mbetet shqetësues niveli i shkatërrimit të grupeve kriminale nëpërmjet një qasjeje objektive, faktike dhe jo-selektive. Sundimi i ligjit është guri i qoshes në rregullimin e aktiviteteve ekonomike dhe në luftimin e korrupsionit, megjithatë ai duhet të shoqërohet me hetime të pavarura, gjyqësi të pavarur dhe ndjekje penale të lirë nga ndërhyrjet qeveritare.<sup>62</sup> Gjithashtu shqetësues në të kaluarën ka qenë edhe emërimi i ish-zëvendës Ministrit të Punëve të Brendshme në cilësinë e koordinatorit nacional të qeverisë i kundër trafikimit në vitin 2008, gjithashtu i njohur si anëtar i Shërbimit Informativ të Kosovës, rrjeti i intelegjencës besnik ndaj partisë së PDK-së, shpeshherë i cituar për aktivitete të kontrabandës dhe të krimit të organizuar.<sup>63</sup> Vetëm kohët e fundit mjedisi për mundësimin e trafikimit është raportuar gjithashtu të jetë shqetësues për Kosovën.<sup>64</sup> Me pak dënime të fundit të krimeve të trafikimit të disa zyrtarëve të policisë, Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale apo të zyrtarëve të tjerë qeveritarë<sup>65</sup>, atakimi i grupeve të krimit të organizuar duhet të jetë një prioritet për qeverinë e tanishme të Kosovës, e zgjedhur në bazë të zgjedhjeve të qershorit 2014.

Megjithatë, Policia e Kosovës cilëson se shumë prej shkeljeve penale të trafikimit me njerëz janë kryer nga individë, edhe pse grupet e krimit të organizuar janë aktive dhe dihet se operojnë në Kosovë.<sup>66</sup> Për më tepër, mandati i Drejtorisë për Hetime të Trafikimit me Qenie Njerëzore brenda Policisë së Kosovës është që të hetojë veprat penale të krimit të organizuar (neni 283), skllavërinë, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe punën e detyruar (neni 169), prostitucionin e lehtë ose imponues (neni 241) dhe martesat e detyruara (neni 246), vepra penale që lidhen me trafikimin e

---

<sup>61</sup> Ibid, faqe 51.

<sup>62</sup> Shih për shembull Philips, David L. "The Balkans' Underbelly" në World Policy Journal, Volumi 27, Numër 3, 2010, faqe 93-98.

<sup>63</sup> Në lidhje me SHIK dhe aktivitetet e ngjashme të kontrabandimit, shih për shembull, Philips David L. "The Balkans' Underbelly" në World Policy Journal, Volumi 27, Numër 3, 2010, faqe 93-98.

<sup>64</sup> Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, [2014 Trafficking in Persons Report](#), Tier 2, i disponueshëm tek <http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/countries/2014/226755.htm>. See also pg. 210 of the 2015 Trafficking in Persons Report available at <http://www.state.gov/documents/organization/243560.pdf>.

<sup>65</sup> Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, [2014 Trafficking in Persons Report](#), Tier 2, i disponueshëm tek <http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/countries/2014/226755.htm>. Shiko gjithashtu faqe 210 të Raportit për Trafikim me Njerëz i vitit 2015 i disponueshëm tek [at http://www.state.gov/documents/organization/243560.pdf](http://www.state.gov/documents/organization/243560.pdf).

<sup>66</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtarë të lartë të Policisë së Kosovës, 21 prill 2015, Prishtinë.

personave.<sup>67</sup> Në vitin 2014, Policia e Kosovës ka arritur të shkatërrojë shtatë (7) grupe kriminale të trafikimit me njerëz, që veprojnë në nivelin e brendshëm d.m.th. në nivel të Kosovës.<sup>68</sup> Sipas Policisë së Kosovës, në vitin 2014 trafikimi i personave ka ndodhur kryesisht brenda Kosovës dhe kështu ka ndodhur edhe shfrytëzimi i viktimave të trafikimit. Ndryshe, Departamenti Amerikan i Shtetit tregon se "...qytetarët e Kosovës nga trafikantët i nënshtrohen prostitucionit të detyruar dhe punës së detyruar nëpër të gjithë Evropën." Shkatërrimi i këtyre grupeve kriminale të krimit të organizuar, duke i përfshirë edhe ato që ndodhen jashtë Kosovës, duhet të jetë një prioritet për veprimet e Policisë së Kosovës në të ardhmen e afërt. Nuk ka pasur hetime të përbashkëta të kryera jashtë Kosovës, por vetëm shkëmbim të informacionit nga ana e PK-së në 23 raste.<sup>69</sup> Duke qenë se Policia e Kosovës ka mbetur jashtë anëtarësimit në INTERPOL, Policia e Kosovës nuk mund të mbështes reagimin e dobët në shkatërrimin e grupeve kriminale të krimit të organizuar në lidhje me trafikimin.<sup>70</sup>

Njësia hetimore e PK-së mbi trafikimin me qenie njerëzore aktualisht ka 56 hetues për rastet e trafikimit me njerëz, me një ndarjen gjinore prej vetëm 11 hetueseve femra nga 56 në total. Sipas Policisë së Kosovës Departamenti tash ka burime të mjaftueshme përveç marrjes së financimit shtetëror edhe financimin nga donatorët e programeve ndërkombëtare si Departamenti Amerikan i Projektit të Drejtësisë ICITAP-it (Programi i Trajnimit të Hetimit Kriminal Ndërkombëtar).<sup>71</sup> Për më tepër, departamenti për trafikim me njerëz i PK-së ka kryer disa trajnime dhe gjithashtu edhe vizita studimi me qëllim të shkëmbimit të përvojave me vendet e tjera në këtë fushë.<sup>72</sup> Megjithatë, Raporti TIP vëren se ka pasur një ulje të trajnimeve nga Akademia e Policisë prej 44 trajnimeve në vitin 2013 në 24 trajnime në vitin 2014 për njësinë speciale të kundër trafikimit të policisë dhe policisë kufitare.<sup>73</sup> Për më tepër, BE-ja gjithashtu vëren se ekziston nevoja e mëtejme për trajnime në lidhje me standardet ekzistuese të procedurave operative të dokumenteve që duhet të ofrohen palëve pjesëmarrëse siç janë policia kufitare, në mënyrë që PK të jetë në gjendje që të kap me sukses krimin ndërkufitar, përfshirë edhe krimet e trafikimit.

Sipas PK-së hetuesit përgatiten mirë për të zënë rastet e trafikimit, por procesi çalon edhe me angazhimet në nivel të prokurorisë dhe gjyqësisë, kryesisht për shkak të mungesës së profilizimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve për t'u marrë me rastet e trafikimit. Për më tepër, rastet e trajtuara nga Zyra e Prokurorisë Speciale (PSRK), me prokurorë më të profilizuar procesi zakonisht shkon më normalisht. Megjithatë, PSRK merret kryesisht me rastet e krimit të organizuar dhe të trafikimit me njerëz në Kosovë; kohët e fundit Policia e Kosovës ka trajtuar raste që kanë qenë të përqendruara më tepër raste individuale sesa në mënyrat e krimit të organizuar dhe në atakimin e grupeve të krimit

---

<sup>67</sup> Broshura e Drejtorisë për Hetim të Trafikimit me Qenie Njerëzore "STOP Trafikimit me Qenie Njerëzore", financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit (US.DOS INL) dhe ICITAP misioni në Kosovë. I disponueshëm në KIPRED.

<sup>68</sup> KIPRED komunikim elektronik me Policinë e Kosovës për informacion dhe media, prill 2015.

<sup>69</sup> *Supra note (shënim si më lart)* 65, faqe 211.

<sup>70</sup> Intervistë e KIPRED me këshilltarin policor të EULEX për PK, prill 2015, Prishtinë.

<sup>71</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtarin e lartë të policisë së Kosovës, 21 prill, 2015, Prishtinë.

<sup>72</sup> Intervistë e SiV me zyrtarin nga Zyra Rajonale e Policisë Pejë, 27 prill, 2015, Pejë.

<sup>73</sup> *Supra note* 65, faqe 211.

të organizuar.<sup>74</sup> Gjithashtu, prokurorët e PSRK-së shpesh kanë vështirësi për të vërtetuar rastet e trafikimit me njerëz në gjykatë që lidhen me grupet e krimit të organizuar.<sup>75</sup> Për shembull prej krijimit të PSRK-së në vitin 2010, ata kanë trajtuar vetëm 15 raste të trafikimit dhe kanë qenë në gjendje që të akuzojnë vetëm 6 raste, të cilat kanë përfshirë gjithsej 34 persona.<sup>76</sup> Kjo përmbledhje tregon cila është tendenca e ndjekjes penale të rasteve të trafikimit me njerëz, e bërë në baza individuale dhe jo me një qasje ndaj rrjeteve të krimit të organizuar, gjë që do të kërkonte hetime të intelgjencës pro-aktive për grupet kriminale si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës.

Gjatë vitit 2014, Policia e Kosovës ka hetuar në përgjithësi 45 raste të trafikimit me njerëz dhe ka arrestuar 66 persona të dyshuar për përfshirje në këtë vepër penale.<sup>77</sup> Nuk ka pasur bashkëpunim të PK-së me EULEX-in, dhe të gjitha rastet e trafikimit me njerëz janë iniciuar, hetuar dhe ndjekur nga Policia e Kosovës. PK-ja ka kryer hetime pro-aktive në më shumë se 90% të rasteve, duke shfrytëzuar gjithashtu edhe masa teknike të fshehta të hetimit të parapara me procedurën penale.<sup>78</sup> Përveç kësaj, PK-ja ka dorëzuar në zyrat e Prokurorive 31 padi penale kundër 86 personave.<sup>79</sup> Megjithatë, hetimet nga ana e Policisë së Kosovës në rastet e trafikimit kanë shënuar përmirësim të lehtë në fillim të vitit 2015. Vetëm në tremujorin e parë të vitit 2015, Policia e Kosovës i kryer 37 hetime, me vetëm 8 (tetë) raste më pak sesa gjatë tërë vitit 2014 (Shih Tabelën 1.1).<sup>80</sup> Nëse Policia e Kosovës do të ruaj këtë shpejtësi duke rritur edhe hetimet në rrjete e sipër të krimit të organizuar brenda dhe jashtë Kosovës, ajo mund të jetë në gjendje që gjatë vitit 2015 të përmirësojë kapjen e gjurmëve dhe identifikimin e viktimave të trafikimit.

Identifikimi zyrtar i viktimave të trafikimit kryhet nga njësi speciale e kundër trafikimit të Policisë së Kosovës e njohur si Njësia e Trafikimit me Qenie Njerëzore. Për më tepër, identifikimi zyrtar kryhet në bazë të ligjit të Kosovës mbi Parandalimin e dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe identifikimi i viktimave kryhet nga ana e prokurorisë, mbrojtësi i viktimave dhe qendrave për punë sociale.<sup>81</sup> Kurdo që këto autoritete kanë dyshime të arsyeshme për të besuar se një person i caktuar është viktimë e trafikimit, ata mund të veprojnë në përputhshmëri me Procedurat Standarde Operacionale të aplikueshme. Pastaj rastet referohen në Strehimoret për Strehim të Përkohshëm të Viktimave të Trafikimit (SSP -VI), ku viktimës përfituese iu ofrohen të gjitha kushtet e ofruara në

---

<sup>74</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtarin e lartë të Policisë së Kosovës 21 prill 2015, Prishtinë

<sup>75</sup> Intervistë e KIPRED me prokurorin special, 29 prill 2015, Prishtinë

<sup>76</sup> Intervistë e KIPRED me prokurorin special, 29 prill 2015, Prishtinë

<sup>77</sup> Komunikim elektronik i KIPRED me Zyrën për Informim dhe Media të Policisë së Kosovës , prill 2015.

<sup>78</sup> Ibid.

<sup>79</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës, 2014 Raporti Vjetor Ndër Institucional për Harmonizim të Statistikave, faqe 70. I disponueshëm tek, [http://www.psh-ks.net/repository/docs/RAPORTI\\_2014\\_MEKANIZMI\\_PERCJELLES.PDF](http://www.psh-ks.net/repository/docs/RAPORTI_2014_MEKANIZMI_PERCJELLES.PDF)

<sup>80</sup> Komunikim elektronik i KIPRED me Zyrën për Informim dhe Media të Policisë së Kosovës, prill 2015.

<sup>81</sup> Shiko Ligjin mbi Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore Kapitulli III. Neni 12, Identifikimi zyrtar i viktimave të trafikimit. I disponueshëm tek,

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20preventing%20and%20combating%20trafficking%20in%20human%20beings.pdf>

bazë të rregullores së brendshme të qendrës.<sup>82</sup> Prandaj, viktimave iu ofrohet strehim, akomodim, trajtim shëndetësor dhe ekzaminim mjekësor, ushqim, veshmbathje dhe këshillim psikik-social.

Siç është vënë në pah më lart, një ndër vërejtjet e BE-së ka qenë edhe nevoja për të përmirësuar më tutje identifikimin e viktimave të trafikimit. Brenda rasteve të trafikimit me njerëz të hetuara gjatë vitit 2014, PK ka identifikuar 42 raste të viktimave të trafikimit.<sup>83</sup> Si rezultat i ligjeve të migrimit, ka pasur një rënie të viktimave të huaja dhe gjatë viteve 2014, 2015, ku shumica e viktimave të trafikimit kanë qenë me origjinë kosovare, me 36 viktime, nga gjithsej 42 të identifikuara. Janë identifikuar edhe viktime të kombeve të tjera, me numrat më të ulët, përfshirë Shqipërinë, Serbinë dhe Rumaninë (shih tabelën 1.2). Moshë e viktimave është gjithashtu shqetësuese, pasi që viktime janë vajzat e reja kryesisht të moshës mes 14 dhe 17 vjeçe (gjithsej 18 viktime), kurse ndërmjet moshës 18 dhe 22 vjet ka pasur 11 viktime. (Shih tabelën 1.3). Identifikimi i viktimave mbetet sfidë për Policinë dhe Prokurorinë. Edhe Policia e Kosovës e edhe Prokuroria përballen me vështirësi kur bëhet fjalë për identifikimin e viktimave pasi ata nuk kanë qasje pro-aktive të avancuar kur bëhet fjalë për përdorimin e masave të fshehta.<sup>84</sup> Kur bëhet fjalë për Policinë e Kosovës, ky përbënë një problem strukturor, pasi që atyre u mungon një njësi e cila do të merrej në mënyrë ekskluzive me hetime pro-aktive.<sup>85</sup> Përveç kësaj, kombinimi i ekipeve të shumta hetimore, nga njësi të ndryshme si njësi e hetuesve të drogës dhe lëndëve narkotike, dhe gjithashtu hetuesit e njësisë speciale antitrafik të policisë mund të jetë shumë efikase.

Në krahasim me vitet e kaluara, puna e PK-së është përmirësuar në masë të madhe, megjithatë, në përgjithësi mungojnë hetimet pro-aktive. Këto probleme mund rrjedhin nga korniza strukturore e PK-së. Një propozim ka qenë që PK mund të përparojë duke krijuar një njësi që merret ekskluzivisht me hetimet pro-aktive.<sup>86</sup> Gjithashtu, ekipet e shumëfishta të hetimit të përbëra nga hetues të njësisë të ndryshme, si hetues nga njësi e drogës dhe lëndëve narkotike dhe hetuesit e krimeve të trafikimit, mund të përmirësojnë më tej cilësinë e hetimeve të PK-së në fushën e trafikimit me qenie njerëzore dhe rastet e krimit të organizuar. Në mënyrë që Policia e Kosovës të përmirësojë më tej efikasitetin e saj në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore, atëherë Policia e Kosovës duhet t'i japë prioritet shkatërrimit të grupeve kriminale të organizuara të trafikimit, përfshirë edhe ato jashtë Kosovës. Përveç shkëmbimit të informacionit me vendet e tjera PK-ja duhet të marrë pjesë edhe në hetime të përbashkëta. Rritja e trajnimeve nga ana e Akademisë së Policisë për ekipin e Njësisë Speciale të Kundër Trafikimit dhe Policisë Kufitare mund të përmirësojë në masë të madhe performancën e përgjithshme të policisë në luftën ndaj krimit të trafikimit me qenie njerëzore dhe paralelisht të rris përdorimin e tyre të hetimeve pro-aktive.

---

<sup>82</sup> Intervistë dhe komunikim elektronik i KIPRED me zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, maj 2015, Prishtinë.

<sup>83</sup> Komunikim elektronik i KIPRED me zyrën e policies së Kosovës për informim dhe media, prill 2015.

<sup>84</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtar nga departamenti për hetime i EULEX-it, 23 prill, Prishtinë.

<sup>85</sup> Ibid.

<sup>86</sup> Ibid.



## b) Ndjekja dhe dënimi i rasteve të trafikimit me njerëz

Gjatë vitit 2014 autoritetet gjyqësore kanë vazhduar të ofrojnë një nivel të ulët të ndjekjes dhe dënimit të krimeve të trafikimit me qenie njerëzore. Të dhënat e dobëta kanë rezultuar nga grumbullimi i lëndëve nëpër gjykatat e Kosovës, nga mungesa e vazhdueshme e prokurorëve dhe gjyqtarëve të specializuar në trajtimin e shkeljeve penale në lidhje me rastet me trafikimin me qenie njerëzore, dhe si rezultat i hezitimit të viktimave të trafikimit për të bashkëpunuar me autoritetet e sundimit të ligjit. BE-ja gjithashtu ka theksuar këto të meta edhe në raportet e veta të progresit për Kosovën. Për më tepër është theksuar nevoja për përmirësimin e kurseve të trajnimit për gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët trajtojnë rastet e trafikimit.

Dënimet për trafikim me qenie njerëzore të dhëna nga PK së bashku me dënimet penale të dhëna nga institucionet e tjera janë trajtuar nga shërbimet e ndjekjeve penale. Gjatë vitit 2014 në të gjitha zyrat e Prokurorisë Themelore të Kosovës janë proceduar gjithsej 66 raste të trafikimit me qenie njerëzore kundër 181 personave.<sup>87</sup> Megjithatë, shërbimet për ndjekje penale kanë arritur që të zgjidhin vetëm 22 raste kundër 56 personave, apo 33% të tyre. Nga fundi i vitit kanë mbetur të pazgjidhura 44 raste të trafikimit me qenie njerëzore kundër 125 personave, apo në përgjithësi 67% e tyre. Shumica e dënimeve penale janë dhënë nga PK. Trendi i ndjekjeve penale me vetë-iniciativë, të kryera nga shërbimet e ndjekjeve penale ka vazhduar edhe me rastet e trafikimit me qenie njerëzore, dhe si rezultat nuk ka pasur asnjë rast të iniciuar nga ta.<sup>88</sup>

Prej 22 rasteve të zgjidhura të trafikimit me qenie njerëzore kundër 56 personave, prokurorët kanë parashtruar padi kundër 38 personave. Për më tepër, kallëzimet penale kundër 18 personave janë refuzuar dhe hetimet ndaj tyre janë ndërprerë. Prokurorët kanë urdhëruar në total përdorimin e 86 masave të fshehta në përcjelljen e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore.<sup>89</sup> Përdorimi i masave të tilla nga ana e PK-së të urdhëruara nga ana e prokurorit tregon një përmirësim të dukshëm në krahasim me atë të viteve të kaluara, si rezultat i trajnimeve të hetuesve të PK-së.<sup>90</sup>

Gjykatat sërish kanë vazhduar të kenë vështirësi për t'i mbajtur përgjegjës autorët e trafikimit.<sup>91</sup> Shpesh, prokurorët kanë zbritur apo reduktuar dënimet e trafikimit, duke i konsideruar ato si dënime të rasteve që nuk ndërlidhen me trafikim, dënimi i trafikuesve ka vazhduar të jetë më i ulët se sa periudha e parashkrimit, e paraparë me anë të ligjit të aplikueshëm. Gjykatat kanë dënuar më pak trafikues dhe kanë vazhduar të shqiptojnë dënime të buta kundër trafikuesve.<sup>92</sup> Prej 38 aktakuzave të parashtruara nga prokurorët, gjykatat kanë lëshuar aktvendime vetëm për 25 persona, dhe vetëm 24 persona janë shpallur fajtor për ngarkesat përkatëse penale.<sup>93</sup> (Shih tabelën 1.4)

Në çerekun e parë të vitit 2015, zyra e prokurorit ka pasur gjithsej 46 raste të ushtruara kundër 128 personave në procedurë.<sup>94</sup> Shumica e rasteve janë trashëguar nga vitet e mëparshme, ndërsa gjatë tre

<sup>87</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës, 2014, Raporti Vjetor Ndër-Institucional mbi Harmonizimin e Statistikave, faqe 69. I disponueshëm tek, [http://www.psh-ks.net/repository/docs/RAPORTI\\_2014\\_MEKANIZMI\\_PERCJELLES.PDF](http://www.psh-ks.net/repository/docs/RAPORTI_2014_MEKANIZMI_PERCJELLES.PDF)

<sup>88</sup> Ibid, faqe 70.

<sup>89</sup> Ibid, faqe 71.

<sup>90</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtar të lartë nga Policia e Kosovës 21 prill 2015, Prishtinë

<sup>91</sup> Ibid.

<sup>92</sup> Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, [2014 Trafficking in Persons Report. See also TIP Report 2015.](#)

<sup>93</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës, 2014, Raporti Vjetor Ndër-Institucional mbi Harmonizimin e Statistikave, faqe 72.

<sup>94</sup> Komunikim elektronik i KIPRED me zyrtar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, I.P, prill 2015.



muajve të parë të vitit 2015, janë paraqitur vetëm pesë (5) raste të reja. Gjatë kësaj periudhe, prokurorët kanë arritur që të zgjidhin vetëm një lëndë, ndërsa 95% e lëndëve kane mbetur të pazgjidhura. Prokurorët kanë urdhëruar 76 masa të fshehta dhe kanë ngritur aktakuza për gjashtë (6) persona.<sup>95</sup> Ka një rritje të vogël në udhëzimet e prokurorëve për përdorimin e masave të fshehta, duke pasur një nivel të përdorimit të masave të fshehta në tre muajt e parë të vitit 2015 prej 10 më pak se sa në vitin 2014. Duke ndjekur aktakuzat e ngritura nga prokurorët, gjykatat kanë lëshuar aktvendime për vetëm një nga personat e akuzuar të shpallur fajtor (Shih tabelën 1.5).

Një tjetër mangësi në ndjekjen penale të rasteve të trafikimit me qenie njerëzore është mbështetja e përgjithshme e prokurorëve në dëshminë e viktimës. Në rast se viktimat tërhiqen nga deklaratat e tyre, rastet mund të përfundojnë të dëmtuara në mënyrë të konsiderueshme.<sup>96</sup> Përveç kësaj, viktimat rrallë pranojnë të jenë viktime të trafikimit, dhe kjo shpeshherë si rrjedhojë e frikës që kanë prej anëtarëve të familjeve të tyre dhe hakmarrjes nga trafikantët.<sup>97</sup> Mungesa e besimit në efikasitetin e sistemit gjyqësor në përgjithësi ndikon gjykimin e tyre të plotë për të bashkëpunuar me autoritetet e sundimit të ligjit.<sup>98</sup> Viktimat zakonisht tërhiqen nga dëshmitë e tyre kur përballen me të pandehurin në gjykatë.<sup>99</sup> Arsytet kryesore mendohet të jenë frika nga hakmarrja, frikësimi apo premtimet e rreme për të ardhmen nga ana e trafikantëve.<sup>100</sup>

Sipas prokurorëve, faza e mbledhjes së dëshmive dhe identifikimi i viktimave janë të kushtueshme dhe komplekse.<sup>101</sup> Prandaj, ka disa raste kur mungesa e fondeve të duhura për të ndjekur këto raste mund të ndikojnë në gatishmërinë për të vazhduar hetimet. Përveç kësaj, dënimet e caktuara nga gjykatat janë konsideruar të jenë të buta, duke treguar qëndrimet e buta të gjyqtarëve ndaj luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore.<sup>102</sup> Për më tepër, dënimet e shqiptuara nga gjykatat e shkallës së parë reduktohen akoma më shumë, pas apelimit të ushtruar në gjykatën e shkallës më të lartë.<sup>103</sup>

Në fund, të dhënat e dobëta statistikore në lëndët e trafikimit me qenie njerëzore përcaktojnë se përpjekjet duhet të përmirësohen akoma më shumë në trajtimin e këtyre shkeljeve penale. Sfidat mbesin akoma për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe hetimet cilësore të drejtuara nga PK-ja. Këto sfida mund të përmirësohen me rritjen e trajnimeve të përbashkëta për policinë, prokurorët dhe gjyqtarët të cilët merren me rastet e trafikimit. Edhe pse institucionet e Kosovës, siç është Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka ofruar trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët me qëllim të avancimit të kapaciteteve të tyre në trajtimin e rasteve të trafikimit, porse trajnime të specializuara për trajtimin e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore kanë qenë të rralla.<sup>104</sup> Për më tepër, specializimi i gjyqtarëve në gjykimin e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore do të mbështesë dhe lehtësojë punën e gjykatave dhe përgjigjet e tanishme. Prandaj, nevoja për të identifikuar këto fusha specifike për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve duhet të shihet si një prioritet për institucionet e Kosovës.

---

<sup>95</sup> Ibid.

<sup>96</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtar të lartë të Policisë së Kosovës, 21 prill, 2015, Prishtina.

<sup>97</sup> Intervistë e SiV me prokurorin e Prokurorisë Themelore të Gjakovës, 23 prill, 2015, Gjakovë.

<sup>98</sup> Intervistë e SiV me gjyqtarin e Gjykatës Themelore të Pejës, 28 prill 2015, Pejë.

<sup>99</sup> Intervistë e SiV me gjyqtarin e Gjykatës Themelore të Gjakovës, 23 prill 2015, Gjakovë.

<sup>100</sup> Intervistë e KIPRED me prokurorin special, 29 prill 2015, Prishtinë.

<sup>101</sup> Intervistë e SiV me prokurorin e Prokurorisë Themelore të Gjakovës, 23 prill 2015, Gjakovë.

<sup>102</sup> Intervistë e SiV me zyrtar të policisë rajonale të Pejës, 27 prill 2015, Pejë.

<sup>103</sup> Intervistë e SiV me gjyqtarin e Gjykatës Themelore të Pejës, 28 prill 2015, Pejë.

<sup>104</sup> Intervistë e SiV me gjyqtarin e Gjykatës Themelore të Gjakovës, 23 prill 2015, Gjakovë.

## V. Përpjekjet e tjera kundër trafikimit

### a) Roli i Koordinatorit Nacional në luftimin e trafikimit

Kosova ka zhvilluar një sërë politikash për qasje ndaj luftës kundër trafikimit, përfshirë edhe emërimin e Koordinatorit Nacional Kundër Trafikimit që nga viti 2008.<sup>105</sup> Koordinatorin është paraparë që të veprojë edhe në cilësinë e Raportuesit Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.<sup>106</sup> Deri më tani Qeveria e Kosovës ka emëruar zëvendës-Ministrat e Punëve të Brendshme si Koordinator Nacional.<sup>107</sup> Ky kusht fillimisht ka qenë i paraparë me Strategjinë e parë të Kosovës dhe Planin e Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2008-2011.<sup>108</sup> Ligji Kundër Trafikimit thekson më tej se emërimi i Koordinatorit duhet të vijë nga qeveria, me monitorimin e Strategjive Kombëtare dhe Sekretariatit e Vlerësimit, që vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.<sup>109</sup>

Fusha tjetër e përgjegjësive të tij përfshinë drejtimin e Autoritetit Kombëtar kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore,<sup>110</sup> dhe bashkëpunimi përfshinë edhe agjencitë e tjera të sundimit të ligjit, në mënyrë që të parandalohet dhe luftohet trafikimi me qenie njerëzore dhe të mbrohen viktimat e trafikimit.<sup>111</sup> Gjithashtu, Koordinatorin duhet të zhvillojë, të koordinojë dhe monitorojë zbatimin e mekanizmave kombëtare të referimit në mënyrë që të sigurohet identifikimi i duhur, referimi, ndihma dhe mbrojtja adekuate e viktimave të trafikimit, duke përfshirë edhe të fëmijëve viktimat.<sup>112</sup>

Pas zgjedhjeve të fundit parlamentare të mbajtura në qershor 2014 dhe krijimit të qeverisë së re, Kosova është akoma në pritje të emërimit të zëvendës ministrit të punëve të brendshme. Respektivisht, Koordinatorin Nacional i Kundër Trafikimit nuk është emëruar akoma, ndërsa qeveria pretendon se roli i tij/saj ushtrohet nga vetë Ministri i Punëve të brendshme, dhe se zëvendës Ministri i Punëve të Brendshme do të emërohet nga Kryeministri.<sup>113</sup> Për më tepër, disa institucione të përfshira në përpjekjet kundër trafikimit nuk kanë njohuri se kush është duke e luajtur rolin e Koordinatorit Nacional.<sup>114</sup> Të paktën ish Koordinatorin Nacional i emëruar ka demonstruar një rol të rëndësishëm në organizim, duke bërë thirrje për takime të rregullta të Autoritetit Kombëtar dhe

---

<sup>105</sup> Sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 29 datë 10/04/2008.

<sup>106</sup> Faqe 11, Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, 2011-2014. I disponueshëm tek <https://www.mpb-ks.org/repository/docs/tqnjanglisht.pdf>.

<sup>107</sup> Shih për shembull Vendimin e Qeverisë Nr. 29 datë 10/04/2008.

<sup>108</sup> Faqe 8 e Strategjisë: [https://mpb-ks.org/repository/docs/strategjia\\_nacionale\\_dhe\\_plani\\_i\\_veprimit.pdf](https://mpb-ks.org/repository/docs/strategjia_nacionale_dhe_plani_i_veprimit.pdf).

<sup>109</sup> Neni 8, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/l-218 Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.

<sup>110</sup> Autoriteti Kombëtar kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore (më tej: Autoriteti Kombëtar) përbëhet nga, Çdo ofrues i shërbimeve në kuadër të këtyre institucioneve, i cili në bazë të këtij ligji apo ndonjë ligj tjetër përkatës është i autorizuar që të merret me parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe sigurimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuar. Neni 6, Paragrafi 1.1 - 1.18.

<sup>111</sup> Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Neni 8, Paragrafi 2.

<sup>112</sup> Ibid, Neni 8, Paragrafi 3.

<sup>113</sup> Intervistë e KIPRED me MPB- në përfaqësuesin e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës, dhe zyrtarë të BE-së, maj 2015.

<sup>114</sup> Deklarata e përfaqësuesit të Prokurorisë së Shtetit të Kosovës, në tryezën e rumbullakët të KIPRED dhe SiV e mbajtur në Prishtinë, 29 maj 2015.

përmirësimin e përpjekjeve të koordinimit të qeverisë.<sup>115</sup> Vonesa e fundit në emërimin e koordinatorit Nacional nga ana e qeverisë duhet të trajtohet me urgjencë në mënyrë që Kosova të mos kalojë nëpër pengesa të mëdha në përpjekjet e saj kundër trafikimit.

## **b) Ndihma në integrimin e viktimave të trafikimit**

Një sërë iniciativash janë ndërmarrë në Kosovë gjatë viteve të fundit në mënyrë që të adresohen nevojat dhe të mbrohen të drejtat e viktimave të trafikimit. Në mënyrë specifike, institucionet e Kosovës i kanë përmirësuar përpjekjet e tyre me anë të hapjes së lehtësirave për të ndihmuar dhe strehuar viktimat e trafikimit, duke rritur fondet, duke licencuar por edhe duke shfrytëzuar burime të jashtme shërbimi siç janë OJQ-të në ofrimin e asistencës dhe mbrojtjes, krijimin e mekanizmave të mbrojtjes së viktimave në mënyrë që viktimat të përfaqësohen para dhe pas procedurave gjyqësore, përfshirë edhe krijimin e lejeve të banimit për viktimat e trafikimit.<sup>116</sup> Megjithatë, institucionet e Kosovës për vite me radhë u kanë mohuar të drejtën e kompensimit viktimave të trafikimit të pësuar nga krimet e trafikimit. Kjo është përcjell nga një financim minimal për integrim, duke u mohuar të drejtat e viktimave për rehabilitim afat-gjatë.<sup>117</sup> Sfida kryesore vazhdon të jetë rreziku i ri-viktimizimit për viktimat e krimit të trafikimit.<sup>118</sup> Edhe pse viktimat shpesh dëshirojnë të kthehen përsëri në kushte normale të jetesës dhe synojnë rimëkëmbjen e tyre afatgjatë, gjatë dhe pas përfundimit të proceseve gjyqësore, shpeshherë viktimave u mohohet mbështetja nga familjet e tyre dhe komunitetet e tyre përkatëse.<sup>119</sup> Kjo ka ndikuar që në disa raste viktimat të refuzohen dhe stigmatizohen pa ju mbetur ndonjë zgjedhje tjetër për një jetë normale, dhe shpesh duke mbetur në shënjestër të rrjeteve të trafikimit.<sup>120</sup>

Pos nga institucionet e krijuara, viktimave të trafikimit u ofrohet asistencë dhe strehim edhe nga sektori joqeveritar, shërbime të cilat së fundmi janë licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, OJQ-të ankohen për mungesë të mjeteve dhe fondeve për të adresuar nevojat afat-gjata të viktimave të trafikimit.<sup>121</sup> Për më tepër, asistencë afat-gjatë dhe mundësitë e punësimit për viktimat e trafikimit përballen akoma me mungesë të mbështetjes strategjike nga ana e qeverisë.<sup>122</sup> Në përgjithësi, integrimi dhe rehabilitimi afatgjatë, duke përfshirë mundësitë e edukimit të vazhdueshëm dhe të punësimit për viktimat e trafikimit nuk kanë dominuar prioritetet e përpjekjeve kundër trafikimit në Kosovë.

<sup>115</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtar të EULEX-it nga departamenti i hetimeve , 22 prill 2015 në Prishtinë.

<sup>116</sup> Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, 2014, Raporti për Trafikim me Qenie Njerëzore, Tier 2. Për më tepër Kosova ka themeluar edhe Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë ndaj Viktimave, si pjesë e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës, me 7 zyra rajonale, me gjithsej 37 zyrtarë. Në vitin 2014, ZMNv ka asistuar në 35 raste të viktimave në gjykata. KIPRED ka intervistuar përfaqësuesin e ZMNv, Maj 2015. Shikoni gjithashtu, Buletinin Nr. I i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë ndaj Viktimave, - Viti 2014, Dymbëdhjetë Vite Shërbimi Ndaj Viktimave të Krimit, tek: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/BULETINI\\_ANGLISHT.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/BULETINI_ANGLISHT.pdf), pg.14.

<sup>117</sup> Gjyqtari i Gjykatës Themelore të Gjakovës, në tryezën e rumbullakët të KIPRED dhe SiV, Prishtinë, 29 maj 2015.

<sup>118</sup> Intervistë dhe komunikim elektronik i KIPRED me zyrtarë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, maj 2015, Prishtinë.

<sup>119</sup> Ibid.

<sup>120</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtarë të PK-së dhe Prokurorinë Speciale të Kosovës, prill 2015, Prishtinë.

<sup>121</sup> Intervistë e KIPRED me përfaqësuesin e strehimores, prill 2015, Prishtinë.

<sup>122</sup> Intervistë dhe komunikim elektronik i KIPRED me zyrtarë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, maj 2015 Prishtinë.

Është domosdoshmëri që QK të sigurojë financimin e duhur për ofruesit e strehimit, përfshirë ndihmë financiare dhe objektet më të mira dhe inventarit.<sup>123</sup> Për më tepër, duhet të sigurohet rehabilitim dhe integrim afatgjatë në mënyrë që të adresohen nevojat e viktimave të trafikimit. Pasi që viktimat janë tërhequr në rrjetet e trafikimit si pasojë e diskriminimit dhe mundësive ekonomike të kufizuara për punësim, zbatimi i Ligjit të miratuar së voni për Kompensimin e Viktimave të Krimit, është një mjet i domosdoshëm për t'ju ofruar viktimave mundësi për të bërë zgjedhjen e tyre jetësore, duke përfshirë mbështetjen financiare për mundësitë e punësimit. Si do që të jetë, duhet të mbetet një prioritet miratimi dhe zbatimi i ligjit kundër trafikimit për institucionet e Kosovës si edhe për organizatat nga sektori joqeveritar, që ofrojnë shërbime të asistencës dhe integrimin për viktimat e trafikimit.

### **a) Përpjekjet e kundër trafikimit në luftimin e lypsisë së detyruar tek fëmijët**

Fenomeni i lypsisë tek fëmijët në Kosovë paraqet shqetësim serioz. Fëmijët nga Kosova dhe vendet fqinje, përfshirë Shqipërinë, janë objekt i lypsisë së detyruar brenda vendit.<sup>124</sup> I sanksionuar me anë të ligjit në Kosovë,<sup>125</sup> gjithashtu edhe Raporti i Progresit i BE-së në vitin 2014 ka vërejtur se trafikimi me fëmijë dhe shfrytëzimi i fëmijëve për qëllime të lypsisë, mbesin të larta.<sup>126</sup> Gjithashtu është vlerësuar se ky fenomen është shqetësues për qytetarët, në veçanti në rastet ky lypsarët veprojnë në mënyrë agresive kur kërkojnë të holla.<sup>127</sup> Shumica e lypsarëve fëmijë në Kosovë vijnë nga komunitetet Roma, Ashkali dhe Egjiptas (RAE).<sup>128</sup> Për më tepër, hulumtimi ka theksuar se të ardhurat e përditshme mund të ndryshojnë nga 30 euro deri në 250 euro gjatë sezonit të verës për fëmijët, shpesh të ndara nga trafikuesit e tyre.<sup>129</sup> Policia e Kosovës ka bashkëpunuar me institucionet e Shqipërisë dhe kryer disa operacione me qëllim të grumbullimit dhe kthimit të fëmijëve dhe të rriturve të tyre shoqërues në Shqipëri. Megjithatë, rrugët alternative janë identifikuar dhe në shumicën e rasteve fëmijët dhe të rriturit që i shoqërojnë kanë arritur kthehen prapë në Kosovë.<sup>130</sup> Shpesh fëmijët i njohin zyrtarët policor në rrugë, edhe kur janë të veshur me rroba civile, dhe ikin nga autoritetet e sundimit të ligjit, dhe në këtë mënyrë të frikësuar kthehen në Shqipëri.<sup>131</sup> Veprimet e identifikimit të fëmijëve lypsarë dhe trafikuesve të tyre të mundshëm bëhet më i vështirë kur fëmijët i ndërrojnë lokacionet e tyre dhe lëvizin nga një qytet në tjetrin.<sup>132</sup>

Fëmijët me anëtarë të familjes së moshës madhore dhe trafikues udhëtojnë së bashku nga Shqipëria në Kosovë. Policia kufitare në pikat kufitare tek Qafa e Morinës, Bajram Curri, Qafë Prushi, kanë

<sup>123</sup> Intervistë e KIPRED me përfaqësuesin e strehimores, prill 2015, Prishtinë.

<sup>124</sup> Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, 2014, Raporti për Trafikim me Qenie Njerëzore, Tier 2.

<sup>125</sup> Ligji i Kosovës Nr. 04/L-218 Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Neni 3, paragrafi 1.8.

<sup>126</sup> Komisioni Evropian, 2014, Raporti i Progresit për Kosovën, faqe 58.

<sup>127</sup> Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, 2014 Raporti për Trafikim me Qenie Njerëzore, Tier 2.

<sup>128</sup> Shih projektin MARIO, Raporti i Mbikëqyrjes: Shfrytëzimi i fëmijëve shqiptar (Shqipëria) në rrugët e Kosovës, dhjetor 2010, faqe.2. tek: [http://www.childtrafficking.com/Docs/tdh\\_10\\_kosova\\_original\\_0311.pdf](http://www.childtrafficking.com/Docs/tdh_10_kosova_original_0311.pdf)

<sup>129</sup> Ibid.

<sup>130</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtar të lartë të Policisë së Kosovës, 21 prill, 2015, Prishtinë.

<sup>131</sup> Deklarata e zyrtarit të lartë të Policisë së Kosovës në tryezën e rumbullakët të KIPRED dhe SiV, të mbajtur në Prishtinë, 29 maj 2015.

<sup>132</sup> Deklarata e zyrtarit nga Qendra për Punë Sociale, në tryezën e rumbullakët të KIPRED dhe SiV, të mbajtur në Prishtinë, 29 maj 2015.

lejuar hyrjen në Kosovë edhe në rastet kur dokumentet e identifikimit nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore apo kur i kanë fshehur dokumentet.<sup>133</sup> Kosova ka nënshkruar një protokoll bashkëpunimi me Shqipërinë, dhe është duke zhvilluar negociata që të shtohet lëmosha e fëmijëve në këtë protokoll. Megjithatë, procesi ka mbetur i papërfunduar pasi që Kosova duhet së pari të emërojë Koordinatorin Nacional kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore.<sup>134</sup> Së fundi në Kosovë është përhapur edhe fenomeni i rekrutimit të fëmijëve lypsarë nga vetë fëmijët.<sup>135</sup> Edhe pse lypsharia e fëmijëve është parë shpesh si një formë e shfrytëzimit dhe pjesë e krimit të trafikimit, shpesh PK ngurrton për të shqyrtuar raste të tilla si raste të trafikimit me njerëz. Rastet janë kategorizuar kryesisht si raste të keqtrajtimit dhe braktisjes së fëmijës, siç përcaktohet me anë të Kodit të Procedurës Penale.<sup>136</sup> Në vitin 2014, PK parashtrroi në zyrën e prokurorit 11 raste të keqtrajtimit dhe të braktisjes së fëmijëve.<sup>137</sup> Përveç kësaj, PK-ja ka përcaktuar dy plane operative në mënyrë që të identifikohen rastet e mundshme të fëmijëve që fillojnë si trafikim i fëmijëve. Një qasje më e pranueshme dhe e ri-socializimit është miratuar nga qendrat policore dhe për punë sociale, në vend të miratimit të planeve për heqjen e kujdestarisë në rastet kur prindërit janë hetuar për abuzim apo për keqtrajtim të fëmijës. Sipas ligjit të Kosovës qendrat për punë sociale mund të veprojnë si një autoritet i kujdestarisë për fëmijët që kanë nevojë për ndihmë dhe mbrojtje nga shteti.<sup>138</sup> Procedura të mëtejme penale në këto raste nuk janë raportuar.<sup>139</sup> Edhe pse prokurorët i kanë ofruar ndihmën e tyre PK-së në rritjen e kapaciteteve për të kapur rastet e lypsarisë tek fëmijët dhe për të hetuar rastet e lidhjes potenciale me trafikimin e fëmijëve, rezultatet në këto raste nuk kanë qenë të kënaqshme.<sup>140</sup> PK vazhdon të përballlet me sfida në identifikimin dhe hetimin e mëtejme të këtyre rasteve.

Pasi që trafikimi me qenie njerëzore është gjithashtu një krim ndërkuftar, bashkëpunimi me shtetet e tjera, në veçanti me shtetet fqinje është esencial për të luftuar në mënyrë të suksesshme këtë fenomen. Kosova ka nënshkruar disa marrëveshje me vendet fqinje në mënyrë që të rritet përgjegjësia e tyre bilaterale dhe rajonale.<sup>141</sup> Për shembull, në vitin 2014 Kosova ka nënshkruar një protokoll për bashkëpunim në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore me Malin e Zi dhe me Shqipërinë. Një protokoll i tillë bashkëpunimi me Maqedoninë nuk ekziston, pasi sipas zbatimit të ligjit në Kosovë nuk ka viktima të trafikimit deri më tani të cilat janë identifikuar nga ky vend.<sup>142</sup> Një sfidë tjetër në bashkëpunimin me shtetet fqinje mbetet harmonizimi i legjislacionit të nevojshëm për të rritur efikasitetin e veprimeve të përbashkëta.<sup>143</sup>

Kosova vazhdon të përballlet me pengesa të mëdha në nivelin ndërkombëtar për shkak të njohjes së pjesshme të shtetësisë së saj nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe për shkak të

---

<sup>133</sup> Projekti MARIO, Raporti i Mbikëqyrjes: Shfrytëzimi i fëmijëve shqiptar (Shqipëri) në rrugët e Kosovës, fq.7.

<sup>134</sup> Deklaratë e zyrarit të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, në tryezën e rrumbullakët të KIPRED dhe SiV, e mbajtur në Prishtinë, 29 maj 2015.

<sup>135</sup> Deklaratë e gjyqtarit të Gjykatës Themelore të Gjakovës, në tryezën e rrumbullakët të KIPRED dhe SiV, e mbajtur në Prishtinë, 29 maj 2015.

<sup>136</sup> Kodi Penal i Kosovës, Neni 250, Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës, paragrafi 4.

<sup>137</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtar të lartë të Policisë së Kosovës, 21 prill 2015, Prishtinë.

<sup>138</sup> Shih nenin 1, paragrafi (j) i Ligjit të Kosovës mbi Familjen dhe Shërbimet Sociale, tek: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005\\_02-L17\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_en.pdf)

<sup>139</sup> Ibid.

<sup>140</sup> Deklaratë e zyrarit të lartë nga Policia e Kosovës në tryezën e rrumbullakët të KIPRED dhe SiV, e mbajtur në Prishtinë, 29 maj 2015.

<sup>141</sup> Intervistë e SiV me zyrtar të policisë rajonale të Pejës, 27 prill 2015, Pejë.

<sup>142</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtar të policisë së Kosovës, 21 prill 2015 Prishtinë.

<sup>143</sup> Intervistë e SiV me zyrtar të policisë rajonale të Pejës, 27 prill 2015, Pejë.

mungesës së anëtarësisë së Kosovës. Në shumicën e rasteve në Kosovë, shkëmbimet e informacioneve me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare bëhet nëpërmjet zyrave ndërlidhëse të Njësisë Koordinuese për Zbatimin Ndërkombëtar të Ligjit në Kosovë (ILECU).<sup>144</sup> Megjithatë, sfida mbetet në atë se sa mirë është sinkronizuar Kosova me partnerët e tjerë ndërkombëtarë në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Për më tepër, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informatave është i inkurajuar në nivel ndërkombëtar kryesisht për dy qëllime: a) Që vendet të mund të zvogëlojnë nivelin e trafikimit me qenie njerëzore dhe b) që të dhënat që mbledhen nga autoritetet vendase të mund të shërbejnë tek vendet e tjera partnere për të ndihmuar luftimin e kësaj çështjeje.<sup>145</sup>

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me Serbinë, në rastet e trafikimit me qenie njerëzore dhe shkeljet e tjera penale ndërkufitare, kryesisht bëhen nëpërmjet misionit të EULEX-it në Kosovë. Gjithashtu Kosova ruan kontaktet me Qendrën Ndërkombëtare për Zhvillim të Politikave të Migrimit (ICMPD)<sup>146</sup> në lidhje me Mekanizmat Referues Transnacional.<sup>147</sup> Për shembull, në vitin 2014, numri i përgjithshëm i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore në të cilat Kosova ka shkëmbyer informacione me shtetet e tjera ka qenë 23, ndërsa vetëm në tremujorin e parë të vitit 2015, Kosova ka shkëmbyer informacion për mbi 10 raste të trafikimit me qenie njerëzore. Norma më e lartë e bashkëpunimit ishte me Shqipërinë, me 9 raste të informuara në vitin 2014.<sup>148</sup> Megjithatë, me shtetet e tjera, shkalla vazhdon të jetë e ulët (shih tabelën 1.5). Në përgjithësi, Policia e Kosovës është vlerësuar të jetë më efektive në shkëmbimin e informacionit me hetuesit fqinjë, ndërsa këto praktika janë në një shkallë shumë më të ulët në mesin e prokurorëve dhe gjykatësve.<sup>149</sup>

Në fund, autoritetet e Kosovës duhet të përmirësojnë qasjen e tyre drejt luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore, në veçanti në lidhje me identifikimin e lypsarëve të detyruar. Bashkëpunimi me institucionet duhet të rezultojë në gjetjen e instrumenteve të reja për të ndaluar këtë fenomen. Në mënyrë specifike, bashkëpunimi me policinë dhe qendrat për punë sociale në identifikimin e lypsarëve fëmijë sa më herët që të jetë e mundur së bashku me rrjetet e trafikuesve është më se i nevojshëm.<sup>150</sup> Një tjetër institucion i rëndësishëm në këtë rast janë Doganat e Kosovës. Në të

---

<sup>144</sup> Kjo zyrë është themeluar në prill 2011, me anë të Memorandumit për Mirëkuptim në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Prokurorinë e Shtetit, me qëllim të koordinimit të veprimeve dhe rritjes së efikasitetit të kësaj zyre me institucionet e tjera, me mandate për sundimin e ligjit në Kosovë.. Shiko Këshilli Prokurorial i Kosovës, Memorandumi për Mirëkuptim për Bashkëpunim dhe Mbështetje , Njësia Koordinuese për Zbatimin Ndërkombëtar të Ligjit (ILECU), i disponueshëm tek, <http://www.psh-ks.net/repository/docs/ILECU.pdf>

<sup>145</sup> Këshilli i Evropës raporti i vitit 2014 (Shqipëri) mendon se autoritetet shqiptare duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të përforcuar bashkëpunimin me vendet fqinje dhe vendet e destinacionit të trafikimit në fushat e parandalimit, mbrojtjes së viktimave dhe ndjekjen e autorëve të trafikimit, në bazë të mekanizmave ekzistues dhe duke futur procedura të mëtuqeshme kudo që një gjë e tillë konsiderohet e nevojshme.

<sup>146</sup> ICMPD është një organizatë ndërkombëtare e përbërë nga 15 shtete anëtare, me përfaqësi në të gjithë Evropën, Afrikën e Veriut, Lindjen e Mesme dhe Amerikën Latine. ICMPD ka statusin e vëzhguesit e OKB-së. Qëllimi i ICMPD është që të promovojë politikat e reja, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të migracionit dhe të funksionojë si një mekanizëm të këmbimit të shërbimit për qeveritë dhe organizatat. Për më shumë shih në, <http://www.icmpd.org/about-us/>

<sup>147</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtar të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, 22 prill 2015, Prishtinë.

<sup>148</sup> Komunikim elektronik i KIPRED me zyrën e Policisë së Kosovës për informacion dhe media, prill 2015.

<sup>149</sup> Intervistë e KIPRED me prokurorin e EULEX-it, 23 prill, 2015, Prishtinë.

<sup>150</sup> Deklarata e gjyqtarit të Gjykatës Themelore të Gjakovës (Vaton Durguti) në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe SiV, mbajtur në Prishtinë, 29 maj 2015.



vërtetë, doganat duhet të konsiderohen si "mburoja" e parë për të parandaluar kalimin ilegal të kufijve dhe rrjedhimisht ata duhet të trajtohen edhe më tej për masat e hershme të identifikimit.

## **VI. Përfundim dhe Rruga Përpara**

Sfidat mbesin në hetimin, ndjekjen dhe përgjegjësinë e gjykatave ndaj trafikimit me qenie njerëzore, përfshirë edhe lypjen tek fëmijët. Argumentimi me dëshmi të mjaftueshme dhe cilësore të rasteve të trafikimit me qenie njerëzore janë thelbësore në mënyrë që të dënohen personat e përfshirë në aktivitetet e trafikimit. Përdorimi i intelgjencës pro-aktive për të shkatërruar grupet e mëdha kriminale, vazhdon akoma të mbetet një sfidë në Kosovë, përfshirë edhe hetimet e krimit të pastrimit të parave, trafikimit të substancave narkotike dhe armëve. Dënimet e lëshuara nga gjykatat konsiderohen të jenë të buta dhe minimale edhe për kundër kërkesave të ligjit kundër autorëve të trafikimit me qenie njerëzore.

Shumica e viktimave në Kosovë vazhdojnë të mbesin gra dhe vajza, që në masë dominuese janë të trafikuar për qëllime të shfrytëzimit seksual. Gjithashtu është raportuar se në masë të madhe edhe burrat janë trafikuar, ndërsa lokalet e trafikimit janë transferuar nga motelet në shtëpi private, sallonet e masazhit dhe klubet e natës.<sup>151</sup> Reintegrimi i viktimave të trafikimit vazhdon të jetë gjithashtu një ndër sfidat më të mëdha. Strehimoret që u ofrojnë shërbime viktimave të trafikimit konfirmojnë se reintegrimi mbetet një sfidë ndër vite në Kosovë pasi që viktimat shpesh kthehen tek rrjetet e trafikimit si rezultat i kapaciteteve të dobëta të zhvilluara të integrimit.

Bashkëpunimi dhe koordinimi me autoritetet kompetente për luftimin e trafikimit me njerëz duhet të përmirësohet edhe më tej, në veçanti, në aspektet e parandalimit, mbrojtjes dhe dënimit adekuat të autorëve të krimit të trafikimit me njerëz. Për më tepër, qeveria duhet të sigurojë asistencë të duhur në mbrojtjen dhe integrimin e viktimave të trafikimit, duke përfshirë edhe krijimin dhe përmbushjen efektive të kompensimit të viktimave të trafikimit. Mungesa e kompensimit të viktimave të trafikimit mbetet një shqetësim serioz duke u mohuar viktimave të trafikimit mundësinë për t'u fuqizuar dhe për të shfrytëzuar mundësinë e një reintegrimi të qëndrueshëm. Rrjedhimisht, krimi i trafikimit do të mbetet një prioritet dhe një sfidë që të përmbushet nga ana e Kosovës, në mënyrë që Kosova të jetë në gjendje që shkojë përpara drejt proceseve të saja të integrimit në BE.

### **Rekomandime:**

Në mënyrë që Kosova të themelojë dhe të rrisë efikasitetin e ligjeve, policisë dhe mekanizmave të zhvilluara, në veçanti pas shpalljes së pavarësisë, institucionet e Kosovës duhet që të ndër marrin hapat në vijim:

- Të zhvillohen fushata të mëtejme në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, në veçanti me grupet e rrezikut të lartë të trafikimit, siç janë vajzat e reja nga zonat rurale;
- Institucionet përgjegjëse mandatarë për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore duhet të sigurojnë implementimin e plotë të legjisllacionit kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe ligjit të ri të adaptuar

---

<sup>151</sup> Shiko Raportin e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve, "Trafikimi me Njerëz", 2015, Kapitulli në lidhje me Kosovën, i cili mund të gjendet tek: <http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/countries/2015/243470.htm>

për Kompensimin e Viktimave, përfshirë edhe kompensimin e viktimave të trafikimit, të mohuara gjatë dekadës së fundit, dhe për më tepër, për viktimat e Kosovës.

- Të përmirësohen të dhënat në hetimin e gjurmëve, ndjekjen dhe gjykimin e autorëve të trafikimit me qenie njerëzore. Gjithashtu, dënimet e shqiptuara duhet të jenë në pajtim me dispozitat e parapara me ligjet e Kosovës dhe të mos lihen në zgjedhjen e gjyqtarëve për të interpretuar atë në bazë të vullnetit të tyre. Trafikuesve të vajzave të reja dhe grave duhet t'ju shqiptohen dënimet e duhura dhe këto dënime duhet të jenë në pajtim me dispozitat e parapara për shkelje penale të trafikimit.

- Institucionet e Kosovës duhet të organizojnë dhe të mbajnë trajnime të specializuara dhe të përbashkëta në lidhje me trafikimin me qenie njerëzore për të gjitha institucionet përgjegjëse, përfshirë, por jo vetëm, Policinë e Kosovës, Doganat e Kosovës, prokurorët, gjyqtarët dhe mbrojtësit e viktimave dhe qendrat për punë sociale, në baza të rregullta dhe jo në baza të rastit (*ad hoc*).

- Autoritetet për zbatimin e ligjit, në veçanti Policia e Kosovës ka nevojë që të zbulojnë modalitetet e mëtejme për të adresuar lypsin e detyruar tek fëmijët dhe rrjetet e mundshme të trafikimit;

- Financimi dhe resurset e mjaftueshme duhet të sigurohen për të gjitha strehimoret e viktimave të trafikimit. Trajnimet e specializuara për stafin përgjegjës të përfshirë të mbrojtjen e viktimave, rehabilitimin dhe integrimin duhet të organizohen sipas nevojës. Në bazë të implementimit të ligjit për kompensimin e viktimave, viktimave duhet t'ju ofrohet mbështetja e mjaftueshme monetare për integrim afat gjatë.



## VII. Shtojca:

**Tabela 1.1. Hetimet e kryera nga Policia e Kosovës gjatë vitit 2014 dhe periudhës Janar – Mars 2015**

Rastet/Hetimet	2014	Janar-Mars 2015
Rastet e hapura	155	63
Rastet e parashtruara në prokurori me kallëzim penal	89	13
Rastet e parashtruara në prokurori me raport special	72	13
Lëndët në hetim e sipër	45	37

*Burimi: Komunikim me email me Policinë e Kosovës*

**Tabela 1.2. Viktimat e identifikuar sipas origjinës**

Viktimat e identifikuar - origjina	2014	2015
Kosovarë	36	5
Shqiptar	4	1
Serb	1	1
Roma	1	0
Gjithsej:	42	7

*Burimi: Komunikim me email me Policinë e Kosovës*

**Tabela 1.3. Viktimat e identifikuar sipas moshës**

Mosha	14 - 17	18 - 22	23 - 25	26 - 30	31 - 35	36 - 40	41 - 50	Gjithsej
Viti 2014	18	11	3	6	2	1	1	42
Janar - Mars 2015	6	1	0	0	0	0	0	7

*Burimi: Komunikim me email me Policinë e Kosovës*

**Tabela 1.4. Aktvendimet e lëshuara nga gjykatat për rastet kundër trafikimit me qenie njerëzore**

Viti 2014	Padia është parashtruar pas hetimeve	Personat kundër të cilëve Gjykata ka lëshuar aktvendim në lidhje me padinë	Të akuzuarit e shpallur fajtor	apo në %	Për të akuzuarin është refuzuar padia	apo në %
Gjithsej	38	25	24	96%	1	4%

*Burimi: Raporti Vjetor Ndër-institucional i KPC, 2014*

**Tabela 1.5. Bashkëpunimi policor ndërkombëtar / Shkëmbimi i informatave (2014- 2015)**

Viti	Shqipëria	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia	Zvicra	Gjermania	Holanda	Ukraina	Suedia	Belgjika	SHBA	Italia	Austria	Anglia	Turqia	Franca	Romania	Moldavia	Gjithsej
2014	9	0	1	2	2	1	1	1	0	2	1	1	1	0	1	1	1	2	23
2015	3	0	1	2	1	1	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	10

*Burimi: Komunikim me e-mail me Policinë e Kosovës*